

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Java nis me tensione, Meri Shehu paralajmëron disa shenja: Përballje, debate dhe pasiguri
ADRESA	https://piranjat.al/lifestyle/java-nis-me-tensione-meri-shehu-paralajmëron-disa-shenja-përballje-deb-i106516
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 21:15:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 21:03:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aa1786f68486b3bfa3830a078235b33bc5ea1a1e8d152fb8fc55a25e5249285d
TEKSTI	f23750098be7bb7326fb0e4adf60f028f5ae725c8f45285a14bde4ff19757d14
PAMJA	eb42f571757e95841a3743929c52c3a5c7de1f5d99fa8de0a0d11f56a48dfa89

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	953260543cf3a9fb22f04b7bed0eeba1e5ab3de56ea401747150f06baa89b536
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81d9502dee89498020984867f5c9e7803768541a0034d6fb041c0efcf168cb37
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/953260543cf3a9fb22f04b7bed0eeba1e5ab3de56ea401747150f06baa89b536>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

meritat dhe

manierë të
mënyrë të
pashmangshme
me drejtësitë e

**Gjëmë e
madhe,**

kërkuar një
reformim të
thellë të

**drejt
"Qytetit"**

dorëheqje",
qytetarët
kanë vijuar
marchimin

**"Skënderbej"
kërkohet**

qytetarëve në
sheshin
"Skënderbej"
nga ky

**plagjiaturën
e ministres**

pena në
SPAK pas
publikimit të
investigimit

LIFESTYLE

Java nis me tensione, Meri Shehu paralajmëron disa shenja: Përballje, debate dhe pasiguri

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 23:03



Java e re nuk duket se do të jetë aspak e qetë në planin astrologjik. Astrologia Meri Shehu ka komentuar lëvizjet e planetëve dhe ndikimin e tyre te 12 shenjat e zodiakut, duke paralajmëruar ditë me tensione, përballje dhe vendime të rëndësishme.

Sipas saj, hyrja e Marsit në Luan dhe përballja e tij me Plutonin në Ujor krijojnë një atmosferë të ngarkuar, veçanërisht për Luanët, Ujorët, Akrepët dhe Demët. Ndërkohë, kalimi i Merkurit në Akrep sjell komunikim më të thellë, vendime më të prera dhe më shumë dyshime.

"Ditët e para do të kemi përballje. Marsi në Luan bëhet gati të përballlet me Plutonin në Ujor dhe kjo është një përballje që mban shumë tension. Kështu që kujdes, Ujor, Luan, Akrep, Dem, sepse do të keni përballje", u shpreh Meri Shehu.

Por si do të jetë java për secilën shenjë?

Dashi

Marsi në Luan u jep Dashëve energji dhe dëshirë për të çuar deri në fund një plan apo projekt krijues. Megjithatë, këmbëngulja mund t'i çojë edhe drejt përplasjeve apo vendimeve të rrezikshme. Sipas Shehut, çështjet ekonomike kërkojnë më shumë kujdes, ndërsa në jetën personale mund të rikthehen disa situata të së kaluarës.

Demi

Kjo nuk duket si java më e lehtë për Demët. Tensionet familjare, debatet dhe paqartësitë mund të shtohen, ndërsa në bashkëpunime mund të shfaqen dyshime, xhelozia apo nevoja për sqarime. Këshilla e astrologes është të tregohen veçanërisht të kujdesshëm në marrëdhëniet me të tjerët.

Binjakët

Kalimi i Merkurit në Akrep mund të sjellë pasiguri në punë, bashkëpunime dhe projekte. Edhe çështjet ligjore, udhëtimet apo komunikimi me jashtë mund të kërkojnë më shumë vëmendje. Edhe marrëdhëniet me njerëzit e afërt mund të shoqërohen me tensione.

Gaforrja

Pas një periudhe të lodhshme me Marsin në shenjën e tyre, Gaforret përjetojnë një lloj lehtësimi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se sfidat përfundojnë. Ekonomia, projektet personale dhe disa diskutime të vështira do të kërkojnë kujdes, sidomos në ditët e para të javës.

Luani

Marsi në shenjën e Luanit i bën edhe më këmbëngulës për të realizuar atë që kanë në mendje. Dëshira për të vendosur vetë dhe për të pasur kontroll mbi situatat do të jetë e fortë. Por përballja me Plutonin në Ujor mund të sjellë tensione, veçanërisht në bashkëpunime.

Virgjëresha

Virgjëreshat mund të ndihen të pakënaqura dhe të pasigurta për drejtimin që po marrin disa prej planeve të tyre. Sipas Meri Shehut, mund të shfaqen kundërshtime, madje edhe nga persona që i kanë konsideruar aleatë. Prapaskenat dhe tensioni psikologjik mund të shtohen, ndaj astrologia këshillon më shumë kujdes.

Peshorja

Jeta sentimentale dhe marrëdhëniet vazhdojnë të jenë në fokus për Peshoret. Komunikimi dhe jeta sociale kanë marrë një shtysë, por çështjet ekonomike mund të krijojnë konfuzion. Dielli në shenjën e tyre u jep një ndikim pozitiv, megjithatë duhet të përpiqen të ruajnë ekuilibrin në marrëdhëniet me të tjerët.

Akrepi

Akrepat marrin vlerësimin më të lartë të javës. Afërdita në shenjën e tyre u jep mundësinë të rishikojnë marrëdhënie, projekte dhe çështje ekonomike. Mund të ketë mundësi për të korrigjuar gabime të së kaluarës, por karriera mbetet një fushë ku mund të ketë përballje të forta. Kujdes edhe me mënyrën e komunikimit.

Shioietari

Shigjetarët mund të ndihen më të pasigurt se zakonisht. Çështjet ekonomike dhe personale mund t'u shkaktojnë shqetësime, ndërsa disa situata të fshehta mund të dalin në pah. Atmosfera konfliktuale mund t'i bëjë të ndihen të provokuar ose të zhgënjyer nga persona të caktuar.

Bricjapi

Java sjell diskutime të vështira për Bricjapët, sidomos në familje dhe në ambientin e punës. Disa zhgënjime mund të dalin në sipërfaqe, ndërsa marrëdhëniet me të afërmit kërkojnë më shumë durim. Edhe projektet dhe angazhimet e përditshme mund të shoqërohen me tension.

Ujori

Ujorët përballen me një javë intensive, sidomos në fushën e bashkëpunimeve. Përballja e Marsit me Plutonin në shenjë e tyre mund të sjellë situata të papritura, paqartësi ose edhe një përgjigje negative në një projekt. Nga ana tjetër, disa çështje të vjetra ekonomike apo të bashkëjetesës mund të rikthehen për t'u zgjidhur.

Peshqit

Peshqit duket se kanë marrë më shumë përgjegjësi nga sa mund të përballojnë dhe kjo mund t'i lodhë. Puna mund të sjellë nervozizëm, tension dhe dëshirë për të hequr dorë nga disa situata. Megjithatë, Afërdita në Akrep mund të ndihmojë në zhblokimin e çështjeve të vjetra, përfshirë situata ligjore, financiare apo personale.

Artikuj te sugjeruar

LIFESTYLE 28 Shtator18:32

[Sipas profecisë së Baba Vangës, këto dy shenja të zodiakut presin fitime të mëdha në fund të 2026-ës](#)

Sipas profecisë së Baba Vangës, Luani dhe Akrepi mund të presin një bum të madh financiar dhe mundësi të shumta për...

LIFESTYLE 28 Shtator18:06

[Ku ishte Kopshi i Edenit? Harta e shekullit të 16-të “tregon” vendndodhjen e mundshme të Parajsës biblike](#)

Një hartë gati pesë shekuj e vjetër, e përfshirë në një Bibël të shekullit të 16-të, po ringjall nj&...

LIFESTYLE 28 Shtator14:25

[Ja çfarë duhet të dini për kujdesin e lëkurës gjatë dushit](#)

Kur bëhet fjalë për kujdesin ndaj lëkurës, zgjedhjet janë thuajse të pafundme. Por kur hyjmë në dush, dilema duke...

LIFESTYLE 28 Shtator07:00

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që presin 12 shenjat e zodiakut gjatë ditës së sotme](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mir&e...

LIFESTYLE 27 Shtator23:51

[Sekreti për një gjumë më të mirë mund të jenë...?](#)

Një studim i ri shkencor ka zbuluar se një dietë e pasur me fibra dhe me shumë llojshmëri ushqimesh bimore mund të ndikojë dre...

LIFESTYLE 27 Shtator23:43

[Nuk negociojnë pagën e tyre, shenjat e Horoskopit që kanë pak miq](#)

Këto shenja të zodiakut nuk i lejojnë lehtë njerëzit e rinj në jetën e tyre, pasi paqja e brendshme është e panegoc...

LIFESTYLE 27 Shtator14:12

[Thonjtë e shkurtër rikthehen në modë, forma katrore që po dominon trendin](#)

Çdo javë shfaqen pafund modele të reja thonjsh dhe së fundmi, vëmendja po zhvendoset jo vetëm te ngjyrat dhe dizajnet, por edhe...

LIFESTYLE 27 Shtator08:04

[Vlerësoni me qetësi anët pozitive dhe negative! Parashikimi i horoskopit, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot](#)

DashiQëndrimi i dikujt po e bën të vështirë për ty të punosh në mënyrë efektive me të. Ti do të do...

LIFESTYLE 26 Shtator22:06

[Ndahet nga jeta fotoreporteri italian që dokumentoi mbërritjen e anijes “Vlora” në Bari](#)

Është ndarë nga jeta në moshën 82-vjeçare fotoreporteri italian Luca Turi, i njohur për dokumentimin përmes fotografiv...

LIFESTYLE 26 Shtator08:03

[Horoskopi për ditën e sotme, 26 Shtator 2026](#)

DashiNëse je treguar hezitues lidhur me një çështje të caktuar, ka shumë gjasa që dikush të të kërkojë...

ME TE VIZITUARAT

LIFESTYLE 28 Shtator

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mirë...

AKTUALITET 28 Shtator

["Do të më vrasin bandat"/ Shqiptari fiton të dr...](#)

Një gjyqtar britanik i dha anonimitet një shtetasi shqiptar, i dënuar disa herë për vjedhje dhe që përballlet me dëbimi...

AKTUALITET 28 Shtator

[Një murale për turistin e vrarë barbarisht në S...](#)

Nga Gregory Leclerc, NICE MATIN Mallëgjimi i thellë, saudade, ndihet këtë të diel në fushën sportive Thérès...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.